



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 533/2 prot

Datë 05.03.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-94116-01-30-2024, me objekt: “Shërbim i printimit dhe fotokopjimit” me fond limit 6,563,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A
- Ankimues:** “Rikon-AL” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga Ismail Qemali, Nd.40, H.28,1050, Yzberisht, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë: L.17 Rr. Dalip Peza, Durrës
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8

Në datën 04.03.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3855 dhe nr.533 prot., datë 04.03.2024 e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/3855 dhe nr.533 prot., datë 04.03.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK si më poshtë:

- *Operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK pretendon që oferta e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK është anomalisht e ulët dhe e paargumentuar.*
- *Operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK pretendon se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK i ka dorëzuar dokumentat e tenderit, referuar nenit 26 të VKM, me vonesë dhe duke shkelur afatet e përcaktuara, pasi publikimi i renditjes së OE në SPE është kryer me date 19/02/2024 dhe njoftimi paraprak i fituesit është kryer në datën 27/02/2024, pra pas 9 ditësh nga publikimi i renditjes.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 05.03.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**